

Mbi 2.3 milion ton mallra në 8 muaj

-Eksportet rriten me 9 përqind-

13.09.2011

---



Gjatë periudhës janar-gusht të këtij viti në kalatat e portit detar të Durrësit janë përpunuar mbi 2.3 milion ton mallra, duke shënuar një rritje prej 6 përqind krahasuar me të njejtën periudhë të vitit 2010.

Sipas statistikave zyrtare të Autoritetit portual, rritjen më të lartë në këto 8 muaj e kanë regjistruar eksportet, me 9 përqind më shumë se periudha janar-gusht 2010.

Eksporti i çimentos rinfuzo me 186 mijë ton dhe prokatet e lllamarinat me 120 mijë ton zenë peshën kryesore të eksporteve të këtij 8-mujori, të cilit i shtohen mbi 264 mijë ton, kryesisht krom dhe mallra të ndryshme “Made in Albania”, të cilat janë nisur me kontejnerë drejt porteve të tjera.

Që nga fillimi i këtij viti anijet tregtare dhe tragetet kanë transportuar jashtë vendit mbi 865 mijë ton mallra gjithsej, ose 74 mijë ton më shumë se e njejta periudhë e vitit 2010.

Ndërkaq importet kanë shënuar një rritje prej vetëm 52 mijë ton, megjithëse vëllimi i përgjithshëm i mallrave të importuara arrin në 1 milion e 437 mijë ton.

Edhe tragetet e linjave, përveç udhëtarëve dhe autoveturave kanë transportuar afro 488 mijë ton mallra me kamjonë dhe trajlera.



